

## **Prof.Asoc.Dr.Eglantina Zyka**

E punësuar me kohë të plotë si personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit Statistike dhe Informatike e Zbatuar, të Fakultetit Ekonomik, Universiteti i Tiranës.

Ka një përvojë pune 22 vjeçare si pedagoge dhe studiuese. Pas diplomimit në Financë-Kontabilitet, në vitin 1999, studimet pasuniversitare i ka kryer në financë (2006) pranë departamentit të Financës në FE-UT dhe ato dokto­rale (në 2011) mbi përdorimin e metodave statistikore në tregun e sigurimeve, në departamentin e Statistikës dhe Informatikës së Aplikuar ne FEUT.

Ka mbrojtur titullin akademik Profesor i Asociuar në vitin 2015.

Fushat e mësimdhënies përfshijnë Bazat e Statistikës, Statistikës së aplikuar, Metodave të kërkimit, Demografisë, Statistikës Sociale. Ekspertiza kërkimore: tregu i sigurimeve, migrimi, varfëria dhe pabarazia, fusha të tjera ekonomike dhe sociale.

Është angazhuar edhe në disa projekte me partnerë të huaj. Ka përfituar disa grante dhe ka kryer specializime në disa universitete të ndryshme jashtë vendit si në: Belgjike, Itali, Luksemburg, Portugali etj.

Ka referuar në konferenca të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe ka botuar artikuj në revista shkencore vendase dhe të huaja në vendet e rajonit, Europën Perëndimore dhe Amerikë.

Znj. Zyka ka qënë anëtare e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor", në Fakultetin e Ekonomisë për periudhën 2019-2021. Që prej vitit 2016 është e angazhuar edhe si eksperte e jashtme pranë Departamentit të Administratës Publike.